

Kur punëtori shëndetësor është në pushim mjekësor, mund të mungojë për kujdesja ndaj pacientëve

Mungesa e stafit gjatë sezonit të gripit mund të ketë një efekt negativ në kujdesin e pacientit dhe të rrisë koston e kujdesit shëndetësor. Nëse një numër i madh i personelit mjekësor duhet të marrë pushim mjekësor për shkak të gripit, kjo mund të pakësojë shërbimet mjekësore, duke përfshirë edhe rastet urgjente.

OBSH rekomandon që të gjithë punëtorët e shëndetësisë të vaksinohen kundër gripit sezonal çdo vjeshtë



Vaksinimi është i sigurt

www.euro.who.int/en/fluaware



**MBRONI VETEN
DHE PACIENTËT
TUAJ NGA GRIPI**

Vaksinohu !





Nëse jeni punëtor i shëndetësisë ju jeni më të ekspozuar ndaj gripit se sa popullata e përgjithshme

Punëtorët e shëndetësisë janë më të rrezikuar nga gripi në krahasim me popullsinë e rritur në përgjithësi, për shkak të natyrës së punës së tyre. Nëse jeni punëtorë të shëndetësisë mund të merrni gripin nga bashkëpunëtorët dhe nga pacientët tuaj.

Disa studime kanë treguar se gjatë epidemive që paraqiten në objekte shëndetësore, më shumë se gjysma e punëtorëve shëndetësorë gjatë kujdesit të pacientëve me grip mund të infektohen me virusin. Vaksinimi kundër gripit për një herë në vit është mënyra më e mirë për të mbrojtur veten kundër sëmundjes.

Sapo të merrni gripin mund t'ia kaloni pacientëve tuaj

Studimet tregojnë se punëtorët shëndetësorë mund të transmetojnë gripin tek pacientët, sidomos tek ata që janë të ndjeshëm ndaj komplikimeve. Gripi është vecanërisht i padëshirueshëm për foshnjat, të moshuarit dhe ata me imunitet të komprometuar dhe sëmundje kronike.

Punëtorët shëndetësorë janë persona të dedikuar ndaj profesionit, prandaj ata shpesh vijnë në punë edhe kur janë të sëmurë, duke rritur kështu rrezikun e transmetimit

Përveç kësaj infeksioni i gripit shpesh është asimptomatik, kështu që mund ta përcillni tek të tjerët edhe nëse nuk ndiheni të sëmurë. Në një studim të kryer, gjysma e punëtorëve shëndetësorë nuk ishin në dijeni se ishin të sëmurë. Vaksinimi mund t'u jep qetësi, se kështu do të zvogëloni mundësinë për të infektuar pacientët tuaj.

